



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr.424/2021
Datë: 29 dhjetor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në takimin 274-të, të mbajtur më datë 29 dhjetor 2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet forma elektronike për procedimin e ankesave në lëmin penale gjatë procedurës paraprake në mes të gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe procedimin e ankesave përmes SMIL-it në Gjykatën e Apelit.
- II. Hapat që duhet të realizohen për procedimin e ankesave përmes SMIL-it gjatë procedurës paraprake në mes të gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit:
 1. Në gjykatat themelore, ankesat regjistrohen me të gjitha të dhënat e duhura, të cilat i bashkëngjiten në SMIL (përfshirë fletëkthesat e pranuar) dhe dërgohen në Gjykatën e Apelit përmes SMIL-it.
 2. Në Gjykatën e Apelit, ankesat pranohen përmes SMIL-it dhe i caktohen gjyqtarëve për procedim të mëtutjeshëm. Ankesa e pranuar duhet të krijohet dhe mbahet edhe si lëndë në formë manuale në gjykatë.
 3. Gjyqtarët në Gjykatën e Apelit, vendimet për ankesa i marrin përmes SMIL-it. Gjyqtari, vendimin e nënshkruara dhe të gjitha të dhënat tjera në lidhje me vendimin i vendosin në SMIL.
 4. Vendimi për ankesë i marr nga Gjykata e Apelit, përmes SMIL-it kthehet në gjykatën themelore.
 5. Gjykata themelore, vendimin e pranuar nga Gjykata e Apelit e vendos në dosjen manuale të lëndës dhe lëndën e procedon më tutje.

- III. Në raste të problemeve teknike me sistem dhe pamundësisë për të dërguar në Gjykatën e Apelit ankesën përmes SMIL-it, gjykatat themelore duhet të dërgoj ankesën në Gjykatën e Apelit në formë manuale, e cila duhet të procedohet edhe në Gjykatën e Apelit në formë manuale. Pasi të kthehet sistemi në punë, gjykatat janë të obliguara që veprimet me lëndë të ndërmarra në formë manuale ti kryejnë edhe në SMIL.
- IV. Obligohet Sekretariati i KGJK-së të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e projektit.
- V. Vendimi hyn në fuqi më datë 29 dhjetor 2021, kurse zbatimi fillon nga data 01 shkurt 2022.

A r s y e t i m

Projekti i SMIL-it, i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Qeverisë së Mbretërisë Norvegjeze, është në vitin e tretë dhe të fundit të zbatimit të Fazës Konsoliduese të projektit të SMIL-it. Si rezultat i zbatimit me sukses të projektit tashmë të gjitha lëndët gjyqësore procedohen përmes SMIL-it dhe janë krijuar kushtet për filluar me largimin gradual të punës manuale nga përdorimi. Për këtë qëllim, është propozuar largimi i punës manuale nga përdorimi dhe të filloj me procedurën paraprake penale. Kjo do të mundësoj që ankesat të procedohen në kohë të shpejtë dhe të kursehen edhe shpenzimet e udhëtimit dhe transportit.

Kwshilli, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 dhjetor 2021, ka shqyrtuar dhe analizuar propozimin e projektit dhe secilën pikë të paraqitur në shkresë dhe ka vendosur për mbështetje në realizimin e projektit.

Andaj, nga kjo që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Projektit TIK/SMIL;
- Sekretariatit të KGJK-së si dhe
- Arkivit.